



REPUBLIKA E KOSOVËS-KOMUNA VUSHTRRI

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT



10 Nr. 804 /2022

Datë: 22.08.2022

Bazuar në Ligjin për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr.04/L-032, Udhëzimin Administrativ Nr.22/2013 “Numri maksimal i nxënësve për klasë dhe raporti mësimdhënës nxënës” dhe bazuar në Kushtet dhe kriterët për regjistrim të nxënësve në klasën e (10) në Gjimnaze dhe Institucionet e Arsimit dhe aftësimi Profesional të shpallura nga MASHT, nr. 1400/22 dt.22.06.2022:

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT NË VUSHTRRI SHPALL

KONKURS PLOTËSUES

PËR REGJISTRIMIN E NXËNËSVE NË KLASËN E DHJETË (10) TË GJIMNAZEVE DHE TË SHKOLLAVE

PROFESIONALE PËR VITI SHKOLLOR 2022/23

Planifikimi për regjistrim të nxënësve në klasën e dhjetë (X) për Gjimnazin në Vushtri:

SHKOLLA	Drejtimi	Nr. i Paraleleve	Nr. Nxënësve në një paralele	Gjithsej për drejtim
Gjimnazi "Eqrem Çabej" Vushtri	Natyror	1	10	10
	Shoqëror – Gjuhësor	1	21	21
Gjithsej:		2		31

**Planifikimi për regjistrim të nxënësve në klasën e dhjetë (X) për shkolla profesionale-
Vushtrri**

Shkolla	Drejtimi	Profili	Nr. i paraleve	Nr.i nx.	Viti i shkollimit
SHMT "Lutfi Musiqi" Vushtrri	Makineri	Operator i Trafikut Rrugor	1	18	2+1
		Operator i Makinave me Dirigjim Kompjuterik	1	21	2+1
		Metalpunues	1	17	2+1
		Zdruktitari	1	21	2+1
		Automekanik	1	13	2+1
	Elektroteknikë	Instalues Elektrik	1	15	2+1
		Energjetikë	1	20	2+1
		Mekatronike	1	16	2+1
		Teknik I sistemeve të TIK-ut	1	1	2+1
			Gjithsej -"Lutfi Musiqi" Vushtrri	9	142
	Ndërtimtari	Ndërtimtari	1	11	2+1
	Kimi-Teknologji	Teknologji e materialeve ndërtimore	1	2	2+1
	Gjithsej: SHMP" BahriHaxha"Vushtrri			2	13

Dokumentet e nevojshme për konkurrim

Nxënësit për të konkurruar për regjistrim në klasën e 10-të në gjimnaze dhe shkolla profesionale, duhet të paraqesin këto dokumente: - Fletëparaqitjen (e cila merret në shkollën në të cilën konkurron) - Dëftesën origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9) dhe - Certifikatën e lindjes.

Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rregulltPër regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të, të gjimnazeve dhe të shkollave profesionale, për vitin shkollor 2021/22, mund të konkurojnë kandidatët të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe nuk janë më të vjetër se 17 vjeç. Nxënësit, të cilët e kanë mbaruar klasën e nëntë (IX) jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë nostrifikimin e dëftesave në MASHT dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.

Konkursin dhe kriteret e detajuara për secilin drejtim i gjeni të publikuara në shkollat përkatëse dhe në web faqen e Komunës së Vushtrrisë; <https://kk.rks.gov.net/vushtrri/>

Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve

-Paraqitja e dokumenteve për gjimnaze dhe shkolla profesionale për vitin shkollor 2022/2023, bëhet më datë : **22, 23, 24** gusht 2022 duke filluar nga ora 8:00-16:00.

-Shpallja e rezultateve plotësuese më **25.08.2022**

-Kthimi i dokumenteve për nxënësit, të cilët nuk janë pranuar do të bëhet prej 29.08.2022 deri me 31.08.2022. duke filluar nga ora 8:00-16:00.

AFATI I ANKESAVE`

Kandidati i refuzuar dhe i cili dyshon se i janë shkelur kriteret e regjistrimit ka të drejt, brenda 24 orëve, nga koha e shpalljes së rezultateve t'i paraqes ankesë drejtorisë së shkollës.

Vërejtje: Mos ankesa në afatin zyrtar, në shkollën përkatëse, nënkupton humbje e të drejtës për ankesë në shkallën e dytë në Drejtorinë e Arsimit (DKA) apo në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT). DKA dhe MASHT nuk shqyrton asnjë ankesë nëse ajo paraprakisht nuk është shqyrtuar nga komisioni përkatës i shkollës.